



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Dr.str. <u>04</u>
Data/Datum: <u>16.01.2019</u>
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE

Nr. _____

Datë: 16.01.2019

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.01.2019, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 489, të datës 26.12.2018, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, nenin 16, nenin 20, të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), nenin 8, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 05/2014, për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinorë si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për hapjen e shqyrtimit publik të Projektit-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026

Neni 1

Me këtë vendim shpallet shqyrtimi publik i Projektit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026.

Neni 2

- 2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, bëhet në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës nga data 25.01.2019 deri me datën 25.02.2019.
- 2.2 Ekspozimi i Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, bëhet nga data 25.01.2019 deri me datën 25.02.2019 në sallën e Kuvendit të Komunës.
- 2.3 Për të gjitha prezantimet publike mbahet procesverbal.
- 2.4 Shqyrtimi publik i Projektit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026 zgjatë tridhjetë (30) ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

- 2.5 Shpallja e shqyrtimit publik të Projektit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, bëhet tetë (8) para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht, tri (3) ditë në gazeta të përditshme, ueb-faqen e komunës dhe në mediat televizive publike dhe lokale.

Neni 3

- 3.1 Në shqyrtim publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projektit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026.
- 3.2 Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Projektit të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, me vite, Korniza Strategjike, Profili i Komunës, vlerësimi i gjendjes, vizioni, qëllimi dhe objektivat, koncepti i zhvillimit hapësinor, plani i veprimit, duke përfshirë të gjitha pjesët e tij.
- 3.3 Projekt-Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, është e qasshme për publikun në formën e shtypur dhe elektronike.

Neni 4

- 4.1 Projekt-Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.
- 4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku me gojë gjatë diskutimeve, me shkrim në librin e vërejtjeve, apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

Shqyrtimi publik i Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026, organizohet nga komuna në suaza të kompetencave me ligj.

Neni 6

- 6.1 Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës 2018-2026.
- 6.2 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi është përgjegjëse Drejtoria e Planifikimit Urban.

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë së PU dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bc.str. 05
Date/Datum. 16.01.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 16.01.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.01.2019, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 06, të datës 10.01.2019, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në Nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, shkronja (c dhe ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2018

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2018, në shumën prej 330,455.59€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve, shpenzime për komunal dhe subvencioneve e transfereve nëpër kodet e programeve dhe nënprogrameve si në vijim:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej 50,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi i Infrastrukturës Publike 18162;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej 50,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi i Arsimit 92010;
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej 60,455.59€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 73011;
 - 1.4 Mjetet financiare në shumë prej 70,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për komunal - 14, programi i Infrastrukturës Publike 18162;
 - 1.5 Mjetet financiare në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi i Zyrës së Kryetarit të Komunës 16002;
 - 1.6 Mjetet financiare në shumë prej 30,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 73011;
 - 1.7 Mjetet financiare në shumë prej 20,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi i Kulturës, Rinisë dhe Sport 85002;
 - 1.8 Mjetet financiare në shumë prej 30,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, programi i Arsimit 92010.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7 dhe 1.8 të këtij vendimi lejohen, për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e faturave për furnizime

me material për zyre, medikamente për shëndetësi dhe derivate të naftës, mbulimin e shpenzimeve për ndihmë qytetarëve për shërim dhe terapi shëndetësore, ndihmë studentëve për studime, ndihmë klubeve sportive, ndihmë për shpenzime të ceremonisë së varrimit dhe projekteve të Organizatave Jo Qeveritare.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Stamp of the Municipality of Fushë-Kosovë, Kosovo. It includes the text: REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA, KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE, DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU. It also contains handwritten fields: Nr.faq/Dr.str. 06, and Date/Datum. 16. 01. 2019.

Datë: 16.01.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 14.01.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 33, të datës 15.01.2018, mbështetur në kërkesën e Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë Nr. 11-346/06-0000691/19, të datës 10.01.2019 dhe kërkesën e përfaqësuesit të Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë Nr. 11-346/06-0000742/19, të datës 11.01.2019, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2019

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2019, në shumë të mjeteve financiare nga buxheti i komunës prej 195€ për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2019, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim shfuqizon vendimin Nr. 15, të datës 01.02.2018 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Palëve dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq./Str.etc.	27	
Data/Datum.	04. 02. 2019	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		

Datë: 04.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.01.2019, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 483, të datës 14.12.2019, paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 27, shkronja (m), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për të biseduar me banorët e fshatit Miradi e Epërme lidhur me ndërtimin e objektit “Repart për riciklim të gomave të përdorura të automjeteve”

1. Për formimin e Komisionit për të biseduar me udhëheqësit dhe banorët e fshatit Miradi e Epërme lidhur me ndërtimin e objektit “Repart për riciklim të Gomave të përdorura të automjeteve”, në përbërje prej shtatë (5) anëtarëve:
 - 1.1 **Sabit Bullatovci** - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 **Ilir Hasani** - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 **Durim Hajra** - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 **Ariana Zogëjani** - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 **Fatime Ismaili** - Zyrtare për planifikim urban dhe leje urbanistike.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një e vendimit është të bisedojnë me udhëheqësit dhe banorët e fshatit lidhur me ndërtimin e objektit për riciklimin e gomave të përdorura të automjeteve, dhe të arrijnë një marrëveshje të përbashkët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga kryesuesja e kuvendit dhe protokollimit në librin e kuvendit të komunës së Fushë Kosovës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së PU, dhe Arkivit.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



		REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU			
Nr./No./Br./str.		28			
Datë/Date.		06. 02. 2019			
		KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE			

Datë: 05.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.01.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 45, të datës 18.01.2019, paraqitur nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (o), nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (k), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e ‘Komisionit për emërtimin, plotësim-ndryshimin e emërtimit të rrugëve dhe vendeve tjera publike’

1. Për formimin e ‘Komisionit për emërtimin, plotësim – ndryshimin e emërtimit të rrugëve dhe vendeve tjera publike’ në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej:
 - 1.1. Sabit Bullatovci – anëtar i Kuvendit, Kryetar i Komisionit;
 - 1.2. Sabri Rexhepi – anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.3. Aida Alimi – anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.4. Doruntina Jashari – anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.5. Bashkim Krasniqi – anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.6. Ejup Qyqalla – shef i Shërbimeve Publike, anëtar;
 - 1.7. Antigona Sahiti – shefe e Planifikimit Urban, anëtare;
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e Vendimit është ‘Emërtimi i rrugëve të reja, shqyrtimi i ankesave të ndërlidhura me plotësim ndryshimin e emërtimit të rrugëve ekzistuese dhe emërtimin e vendeve tjera publike’ në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Mandati i këtij Komisioni fillon nga hyrja në fuqi e këtij vendimi e deri në përfundim të mandatit zgjedhor 2017-2021. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe protokollimit në librin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së PU, dhe Arkivit.**

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. <u>29</u>		
Datë/Datum. <u>06 . 02 . 2019</u>		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Datë: 04.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.01.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 30, të datës 17.01.2019, paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (a, c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a, c), nenin 27, shkronja (ç, ç) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2019

1. Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare, në shumë prej 350,328.82€, prej ‘Kodit të bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve duke e përfshirë edhe mbetjen nga participimi i fermerëve në vitin 2018, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2019 si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare, në shumë prej 78,995.10€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Serrave’;
 - 1.2 Mjetet financiare, në shumë prej 100,385.92€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Motokultivatorëve’;
 - 1.3 Mjetet financiare, në shumë prej 3,934.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Ciklonëve - Shpërndarësve të plehut artificial’;
 - 1.4 Mjetet financiare, në shumë prej 20,710.40€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Pajisjeve bletare’;
 - 1.5 Mjetet financiare, në shumë prej 100,989.40€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Mekanizmit bujqësor’;
 - 1.6 Mjetet financiare, në shumë prej 5,080.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Makinave mjelëse’;
 - 1.7 Mjetet financiare, në shumë prej 5,234.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Laktofrizëve’;
 - 1.8 Mjetet financiare, në shumë prej 15,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Folive’;
 - 1.9 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Plehut artificial’;
 - 1.10 Mjetet financiare, në shumë prej 10,000.00€, nga buxheti i komunës destinohen për realizimin e projektit për blerjen e ‘Pemëve’.

1. Në realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga nënpika 1.1 e deri në nënpikën 1.7 të pikes një (1) të Vendimit, participojnë edhe fermerët e komunës së Fushë-Kosovës në vitin 2019 me 20% të vlerës së projekteve.
2. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës sipas pikës një (1) të Vendimit dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij Vendimi është kompetencë e Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Zyrës së Prokurimit.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit, Drejtorisë së BZHR dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

